



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 165 Prot.

Tiranë, më 04.02.2022

VENDIM

Nr. 25, Datë 04.02. 2022

PËR
MIRATIMIN E PROGRAMIT TË ZHVILLIMIT TË INTEGRUAR PROFESIONAL
TË STAFIT TË KLSH-së PËR VITIN 2022

Bazuar në nenin 39 “Trajnimet profesionale”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t, (ISSAI/IFPP), përkatësisht neni 14, pika 3, të ISSAI-P1 “Deklarata e Limës” mbi vëmendjen e veçantë që i kushtohet përmirësimit të zhvillimit teorik, praktik dhe profesional të të gjithë anëtarëve dhe stafit të auditimit; Parimit 12 “Ngritja e kapaciteteve përmes promovimit të të mësuarit dhe shkëmbimit të njohurive” të ISSAI-P12 “Vlerat dhe dobietë e institucioneve supreme të auditimit - sjellja e ndryshimeve në jetën e qytetarëve”; Planit Strategjik të KLSH-së, 2018-2022, Qëllimit nr. 2 “Optimizimi i kapaciteteve profesionale, aftësive të audituesve, procedurave të punës, logjistikës dhe funksioneve të tjera mbështetëse”; Plan Veprimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1243, datë 12.11.2021, “Mbi zbatimin e rekomandimeve të Raportit të Komisionit European për Shqipërinë të datës 19.10.2021”; Plan Veprimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 755/1, datë 01.09.2021 “Për zbatimin e rekomandimeve të Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së KLSH-së për vitin 2020, miratuar në datë 24.06.2021”, si dhe praktikave më të mira ndërkombëtare që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm profesional që kontribuojnë në përsosjen organizative dhe në zbatimin e kuadrit të objektivave të zhvillimit institucional,

VENDOSA:

1. Miratimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të stafit të KLSH” për vitin 2022;
2. Miratimin e Plan Veprimit për zbatimin e “Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të stafit të KLSH” për vitin 2022;

3. Miratimin e listës së trajnerëve të brendshëm të KLSH, për vitin 2022;
4. Drejtoria e Metodologjisë dhe Zhvillimit ngarkohet me zbatimin e Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të stafit të KLSH për vitin 2022, si dhe me monitorimin, zbatimin dhe raportimin periodik të Planit të Veprimit mbi zbatimin e Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të KLSH për vitin 2022;
5. Të gjithë punonjësit e Kontrollit të Lartë të Shtetit kanë detyrimin e zbatimit të detyrave dhe përbushjes së objektivave të përcaktuara në Programin e Zhvillimit Profesional të stafit të KLSH-së dhe Planit të Veprimit mbi zbatimin e Programit të Zhvillimit të Integruar Profesional të KLSH për vitin 2022;
6. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Arben SHEHU

